



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr. 2223 prot.

Tiranë, më 08/05/2020

URDHËR

Nr. 305, datë 08.05.2020

**“PËR MËNYRËN E VETËKARANTINIMIT TË PERSONAVE QË RIATDHESOHEN“**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 1 gërma c, të Ligjit nr.15/201, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, me qëllim parandalimin e përhapjes së COVID-19 në Republikën e Shqipërisë dhe mbrojtjen e shëndetit të populates,

**URDHËROJ:**

1. Duke filluar nga data 11.05.2020 të gjithë shtetasit shqiptar që riatdheshen në Republikën e Shqipërisë gjatë periudhës së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19 do të vetëkarantinohen në banesë për një periudhë 14 ditore.
2. Mosrespektimi i detyrimit të përcaktuar në këtë urdhër për vetëkarantinim për 14 ditë të personave që riatdheshen është i dënueshëm sipas legjislacionit në fuqi.
3. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor mbikëqyr zbatimin e Urdhrit dhe vendos masën e gjobës, sipas legjislacionit në fuqi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

**Ogerta Manastirliu**

